



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**ZL.Anr.473/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Fatlind Morinës, nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, për shkak të parregullësive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa e Fatlind Morinës, Kryesues i Vendvotimit, nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, e cila identifikohet me shenjën ZL.Anr.473/2017, e datës 23.10.2017.

## **A r s y e t i m**

PZAP - i me datë 23.10.2017 ka pranuar një ankesë nga Fatlind Morina, nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit 1026D/03D, në Hondoc, ka pretenduar se gjatë procesit të votimit për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në VV e lartpërmendur, anëtari i Komisionit Komunal nga ana e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), Drilon Ramabaja, gjatë vizitës në VV nuk ka marrur informata për mbarëvajtjen e procesit nga ai si kryesues i VV-së, por nga komisionerja e vendvotimit e cila po ashtu ka qenë nga LVV-ja.

Paneli, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli pasi që shqyrtoi ankesën, vlerësoi se, pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, nga Fatlind Morina, nga Kamenica, se në një vendvotim në Hondoc të Kamenicës ka pasur parregullsi gjatë procesit të votimit, në Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, janë të pabazuara, pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë e cila do të vërtetonte pretendimet e tij ankimore, ashtu siç parashihet me nenin 117 të LZP-ë.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 115, nenin 117 dhe nenin 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

ZL.Anr.473/2017 me datë 24.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
Zyhdri Haziri



*Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.*